



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 118/2020

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10019, DATË 29.12.2008,
“KODI ZGJEDHOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një grupi deputetësh,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 7 fjalët “organi më i lartë shtetëror i përhershëm” zëvendësohen me fjalët “institucioni shtetëror”.

2. Pika 22 ndryshohet si më poshtë: “Zgjedhje të pjesshme” janë zgjedhjet që kryhen në një apo më shumë njësi të qeverisjes vendore për kryetarin e bashkisë ose për këshillin bashkiak, kur mbetet vakant posti i kryetarit të bashkisë ose kur shpërndalet para kohe këshilli bashkiak.”.

Neni 2

Në nenin 6 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në fjalinë e parë të pikës 1 fjalët “parti politike apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit, i regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor,” zëvendësohen me fjalët “subjekt zgjedhor”.

2. Në pikën 6 fjalët “sipas pikave 1 dhe 3” bëhen “sipas pikës 1”.

Neni 3

Në nenin 10 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 1 fjalët “pikat 1 dhe 2” bëhen “pikat 3 dhe 4”.
2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“Për efekt të caktimit të datës së zgjedhjeve, kohëzgjatja e mandatit të organeve të qeverisjes vendore përllongarit deri në të njëjtën datë të të njëjtit muaj të vitit të katërt pas datës së shpalljes me vendim të KQZ-së në shkallë vendi të rezultateve të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.”.

Neni 4

Në nenin 12 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në fjalinë e tretë të pikës 4 hiqen fjalët “ose KAS-in”.
2. Në fjalinë e tretë të pikës 5 hiqen fjalët “Rregullatorin ose”.

Neni 5

Në nenin 51, në pikën 2 numri “200” bëhet “300”.

Neni 6

Në nenin 65 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“Në momentin e regjistrimit, koalicioni duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të koalicionit. Për nevojat e zbatimit të këtij ligji, të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ky ligj përcakton për subjektet zgjedhore përmbushen nga partia udhëheqëse e koalicionit. Marrëdhëniet midis partive pjesëtare të koalicionit dhe detyrimet reciproke midis tyre rregullohen në marrëveshjen e koalicionit, e cila është pjesë e dokumentacionit që depozitohet nga koalicioni në KQZ.”.

Neni 7

Në nenin 67, pikat 1 deri në 5 ndryshohen si më poshtë:

“1. Partia politike ose koalicioni zgjedhor, në kuptim të nenit 65, që është regjistruar në KQZ si subjekt zgjedhor për zgjedhjet në Kuvend, depoziton në KQZ listën shumëmemërore të kandidatëve të tij për çdo zonë zgjedhore jo më vonë se 50 ditë para datës së zgjedhjeve.

Për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, kandidati për kryetar të njësisë së qeverisjes vendore dhe lista e kandidatëve për këshillat vendore regjistrohen në KZAZ-në që mbulon njësinë e qeverisjes vendore brenda afatit të përcaktuar në këtë pikë. KZAZ-ja dorëzon një kopje të listës në KQZ brenda 48 orëve.

2. Në zbatim të paragrafit të dytë të pikës 1 të këtij neni, lista e subjektit depozitohet në KQZ në rastet kur territori i njësisë së qeverisjes vendore nuk mbulohet nga një KZAZ e vetme.

3. Kandidati për deputet, i regjistruar në një listë shumëmemërore në një zonë zgjedhore, ose kandidati për kryetar bashkie apo për këshillin e bashkisë nuk mund të regjistrohet si i tillë për një zonë zgjedhore tjetër, qoftë edhe për llogari të një partie apo koalicioni tjetër dhe as si i propozuar nga një grup zgjedhësish. Bën përjashtim nga ky rregull kryetari i partisë apo i partisë udhëheqëse të koalicionit, i cili në zgjedhjet për Kuvendin mund të regjistrohet deri në katër zona zgjedhore. Pas shpërndarjes së mandateve sipas këtij ligji, ai nuk mund të zotërojë më shumë se një mandat, të cilin e zgjedh me vullnetin e tij të lirë.

4. Emrat në listën shumëmemërore të subjektit zgjedhor paraqiten të renditura sipas rendit shifror, duke filluar nga numri një. Numri i kandidatëve në listën shumëmemërore nuk mund të

jetë më i vogël se numri i mandateve që do të zgjidhen në zonën zgjedhore përkatëse, shtuar dy. Në çdo rast, numri i kandidatëve në listën shumemërore duhet të jetë i plotpjesëtueshëm me numrin tre. Për koalicionet përbri emrit të kandidatit shënohet cilës parti i përket kandidati.

5. Subjekti zgjedhor nuk mund të ndryshojë renditjen e kandidatëve të listës pas regjistrimit të saj. Kandidatët rirenditen vetëm në zbatim të procedurave të këtij ligji për përlllogaritjen e mandateve fituese në bazë të votimit parapëlqyes dhe të plotësimit të kushtit ligjor për kuotën gjinore.”.

Neni 8

Në pikën 3 të nenit 68 togfjalëshi “6 muajt e fundit” zëvendësohet me togfjalëshin “6 muaj para përfundimit të mandatit të Kuvendit ose të organit të njësisë së qeverisjes vendore, në bazë të vetëdeklarimit të zotëruesve të mandateve për përkatësinë në partinë politike, në institucionin përkatës”.

Neni 9

Në fund të pikës 3 të nenit 88 shtohet fjalia si më poshtë:

“Për partitë pjesëtare në koalicion, numri i votave të vlefshme takuese përlllogaritet duke mbledhur mesataren e votave për mandat për çdo kandidat të zgjedhur nga radhët e tyre.”.

Neni 10

Fjalia e dytë e pikës 2 të nenit 90 shfuqizohet.

Neni 11

Pika 4 e nenit 98 ndryshohet si më poshtë:

“4. Fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor. Mënyra e votimit parapëlqyes përcaktohet nga KQZ-ja në varësi nga numri i subjekteve pjesëmarrëse në zgjedhje, duke respektuar kushtin që informacioni i përcjellë nga fleta e votimit të mos jetë tejet i ngarkuar, konfigurimi i fletës të jetë i qartë e i kuptueshëm për zgjedhësin dhe zgjedhësi ta ketë të lehtë orientimin për votimin e subjektit zgjedhor dhe të kandidatit të parapëlqyer.”.

Neni 12

Pika 3 e nenit 101 shfuqizohet.

Neni 13

Pika 4 e nenit 103 shfuqizohet.

Neni 14

Fjalia e dytë e shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 105 shfuqizohet.

Neni 15

Pika 1 e nenit 106 ndryshohet si më poshtë:

“1. Pasi merr fletën e votimit, zgjedhësi hyn i vetëm në dhomën e fshehtë dhe në fletën e votimit shënon në vendin e përcaktuar nga fleta e votimit për subjektin zgjedhor dhe/ose kandidatin e parapëlqyer të subjektit zgjedhor shenjën “x” ose “+” ose një shenjë tjetër që tregon qartë zgjedhjen e bërë prej tij.”.

Neni 16

Në nenin 117 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Vota të vlefshme janë vetëm fletët e votimit, në të cilat është votuar qartësisht vetëm për njërin nga subjektet zgjedhore dhe/ose vetëm për njërin nga kandidatët e tij. Kur është votuar për më shumë se një kandidat të të njëjtit subjekt zgjedhor, vota i llogaritet vetëm subjektit zgjedhor.”.

2. Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e) është votuar për një subjekt zgjedhor dhe për kandidatin e një subjekti tjetër zgjedhor”.

3. Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “e/1” me këtë përmbajtje:

“e/1) nuk është e qartë se për kë është votuar; ose”.

Neni 17

Në nenin 118 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Fjalja e dytë e pikës 3 shfuqizohet.

2. Pas pikës 6 shtohet pika 6/1 me këtë përmbajtje:

“6/1. Për zgjedhjet për Kuvendin, pas përfundimit të procedurave sipas pikës 6 të këtij neni, bëhet numërimi, sipas së njëjtës procedurë, i votave parapëlqyese për çdo kandidat të subjektit zgjedhor.”.

Neni 18

Përmbajtja e nenit 147 ndryshohet si më poshtë:

“1. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor funksionon për të gjitha llojet e zgjedhjeve dhe referendumeve gjatë mandatit 4-vjeçar të qëndrimit në detyrë.

2. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor thirret në detyrë nga Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor jo më vonë se 50 ditë përpara zgjedhjeve. Kolegji qëndron i mbledhur deri në përfundim të gjykimit të ankimeve ose të kalimit të afateve të ankimit për procesin zgjedhor përkatës.

3. Kolegji rithirret në detyrë nga Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor jo më vonë se 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose për referendumet. Kolegji qëndron i mbledhur deri në përfundim të gjykimit të ankimeve ose të kalimit të afateve të ankimit për këto zgjedhje ose për referendumin.”.

Neni 19

Në nenin 149, pika 1, shkronja “b”, shfuqizohet togfjalëshi “apo ngritje në detyrë”.

Neni 20

Fjalja e dytë e pikës 1 të nenit 162 ndryshohet si më poshtë:

“Për zgjedhjet për Kuvendin përjashtohen nga shpërndarja e mandateve subjektet zgjedhore që kanë marrë më pak se 1 për qind të votave të vlefshme në shkallë vendi.”.

Neni 21

Neni 163 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 163

Shpërndarja e mandateve për kandidatët fitues të listës

1. Menjëherë pas përfundimit të llogaritjes së rezultatit, sipas nenit 162 të këtij Kodi, KQZ-ja përllogarit shpërndarjen e mandateve për kandidatët fitues për secilin subjekt.

2. Shpërndarja e mandateve fillon me rend zbritës, në bazë të renditjes së tyre në listën e dorëzuar sipas nenit 67 të këtij Kodi, duke filluar nga numri rendor një, si dhe numrit të votës parapëlqyese të secilit kandidat bazuar në procedurat dhe kriteret vijuese.

3. Në fillim përfitojnë mandat kandidatët që kanë marrë një numër votash parapëlqyese më të madh se herësi që del nga pjesëtimi i numrit të votave të subjektit me numrin e mandateve të fituara nga subjekti, sipas nenit 162 të këtij Kodi. Në çdo rast, herësi nuk mund të jetë më shumë se 10 000 vota. Në rast se herësi që përftohet nga pjesëtimi është një numër me mbetje dhjetore, si herës merret numri i plotë më i afërt.

4. Kandidatët me numrin më të lartë të votave parapëlqyese se herësi, sipas pikës 3 të këtij neni, zëvendësojnë me radhë kandidatët në listë, që mund të kishin përfitur mandat, të cilët kanë numrin më të vogël të votave parapëlqyese.

5. Ky rregull nuk zbatohet nëse kandidati me më pak vota i përket gjinisë më pak të përfaqësuar. Në këtë rast zëvendësimi kalon te kandidati tjetër i renditur menjëherë më lart me numër votash deri në shterimin e listës sipas të njëjtave kriterë. Kur kandidati me numër më të madh votash se herësi i përket të njëjtës gjini, zbatohen parashikimet e pikës 4 të këtij neni.

6. Pas shterimit të zëvendësimit të kandidatëve sipas pikës 3 dhe 4 të këtij neni, shpërndarja e mandateve vijon me kandidatët e mbetur sipas numrit rendor të listës.

7. Kandidatët e mbetur të listës, që nuk përfitojnë mandate sipas pikave 2 deri 6 të këtij neni, rirenditen në bazë të numrit të votave parapëlqyese duke filluar nga numri më i lartë i votave. Kur numri i votave është i barabartë, renditja përcaktohet me short. Rirenditja sipas kësaj pike përdoret në zbatimin e nenit 164 të këtij Kodi.

8. Përllogaritja dhe shpërndarja e mandateve, sipas nenit 162 dhe këtij neni, për çdo zonë zgjedhore miratohet me vendim. Vendimi nxirret për çdo zonë zgjedhore më vete. Ndaj vendimit mund të bëhet ankim administrativ në KAS.”.

Neni 22

Pika 5 e nenit 164 shfuqizohet.

Neni 23

Pika 3 e nenit 165 ndryshohet si më poshtë:

“3. Koalicionet zgjedhore paraqesin vetëm një kandidat të përbashkët për kryetar bashkie dhe një listë kandidatësh për këshillin bashkiak.”

Neni 24

Pika 3 e nenit 166 ndryshohet si me poshtë:

“Mandatet e këshillave vendorë ndahen nga KQZ-ja në bazë të sistemit proporcional, sipas të njëjtave procedura të parashikuara në nenin 162 të këtij Kodi. Mandatet nominale të këshillave vendorë ndahen bazuar në listën e kandidatëve me rend zbritës, duke filluar nga numri rendor një.”

Neni 25

Neni 179/1 shfuqizohet.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 5.10.2020